



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:036076

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654280

K.DH.SH.II.nr.533/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Komuna e Prishtinës”, me adrese Rr. “UCK” nr.2 Prishtinë, kundër debitorit Selmans Network sh.p.k., me seli në Prishtinë, në çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1661/22 të datës 26.12.2023, më datën 02.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1661/22 të datës 26.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, e ka pranuar si të bazuar propësimin e debitorit Selmans Network sh.p.k, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.78/22 të datës 21.02.2022 të nxjerre nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, me seli të zyrës në Prishtinë, ndërsa e ka anuluar Urdhrit Përmbartimor P.nr.78/22 të datës 21.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Vladrin Beka me seli të zyrës në Prishtinë.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor kreditori dhe atë për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimorë, Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i atakuar të ndryshohet, të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të refuzohet propozimi i debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Komuna e Prishtinës”, me adrese Rr. “UCK” nr.2 Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit Selmans Network sh.p.k., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbarrimor/ Urdhëresës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatorë me numër 21/000606 e datës 23.08.2021 në shumën e gjobës në lartësi prej 600€, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat, me Urdhër Përmbarrimor P.nr.78/22 të datës 21.02.2022, ka caktuar përmbarrimin, duke vlerësuar se dokumenti përmbarrimor/ Urdhëresës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatorë me numër 21/000606 e datës 23.08.2021, i plotëson kushtet për përmbarrim.

Ndaj këtij urdhri ka paraqitur prapësim debitori, duke e kundërshtuar në tërësi urdhër për përmbarrim për shkak se dokumenti në bazë të cilit është nxjerrë urdhëri përmbarrimor nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, po ashtu ka theksuar se urdhri ndëshkimor mbi bazën e të cilit është nxjerre urdhri përmbarrimor nuk i plotëson kushtet nga neni 36 i LPP-së.

Përgjigjen në ankese ka parashtruar kreditori ndaj prapësimit të debitorit, duke theksuar se përmbarrimi është iniciuar në përputhje me nenin 24 par.4 të LPP-së, për çka dokumenti i nxjerrë në procedurën kundërvajtës është bërë i përmbarrueshem, ku kjo përcaktohet në nenin 30 par.4 të Ligjit për Kundërvajtje, po ashtu ka theksuar se meqenëse në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë dëshmi se debitori ka parashtruar ndonjë ankesën ndaj gjobës se dhënë nga Inspektorati Komunal, kreditori ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar prapësimin e debitorit dhe urdhër përmbarrimor P.nr.78/2022 të datës 21.02.2022 ta lejë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivishtë sikur në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas analizimit të propozimit për përmbarrim e konteston se i njëjti është lejuar mbi bazën e dokumentit përmbarrimor/ Urdhëresës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatorë me numër 21/000606 e datës 23.08.2021 në shumën e gjobës në lartësi prej 600€. Prandaj ka theksuar se prapësimi i debitorit është bazuar në nenin 69 lidhur me neni 71 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, andaj të njëjtin në kuptim të nenit 73 paragrafi 3 i LPP-së, vendosi që ta pranoj si të bazuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarrimore, pasi që gjykata e shkallës së parë

duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbaremore.

Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret Urdhëresa e kreditorit Komuna e Prishtinës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatorë me numër 21/000606 të datës 23.08.2021 për shumën e gjobës në lartësi prej 600€ në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbareim, nuk i plotëson kushtet për të qene dokument përmbareimor me titull ekzekutiv, sepse nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 22 par.1.2 dhe nenin 36 par.1 dhe të LPP-së.

Po ashtu me Ligjin për kundërvajtje në nenin 30 par.4 udhëzon në zbatimin e dispozitave të LPP-së, ku përcaktohet se “ *Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbareimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbareim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbareuese në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbareimor*” . Andaj, në këtë rast Ligjit për procedurën përmbareimore , përkatësisht dispozita e nenit 36 përcaktohet se “ *Së bashku me propozimin për përmbareim, organit përmbareuese i dorëzohet edhe dokumenti përmbareues, origjinal apo kopja e vërtetuar, me klauzolën e përmbareueshmërisë për përmbareueshmëri*”, ndërsa në paragrafin 2 përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbareueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetërorë që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”. Prandaj, kjo gjykate vlerëson se nga shkresat e lëndës, respektivisht Vendimit të lëshuar nga Drejtori e Inspektionit – Sektori i Rendit Komuna, Komuna e Prishtinës Nr. 09-355/03-175877/21 të datës 25.08.2021 nuk është origjinal dhe nuk ka asnjë mjete verifikues, vulë, vendim me të cilin do të dëshmohej plotfuqishmëria dhe ekzekutueshmëria e tij konform dispozitave të LPP-së.

Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbareimore, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se vendimi mbi të cilin përmbareuesi privat e ka lejuar urdhrin përmbareimor të debitorit me urdhërpagesën nr. 21/000606 të datës 23.02.2021 nuk paraqet dokument përmbareimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe urdhri ndëshkimor mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbareimor nuk i plotëson kushtet në kuptim të nenit 36 të Ligjit për Procedurën Përmbareimor.

Kjo gjykate, po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar edhe kur e ka shfuqizuar urdhrin përmbareimore dhe anulimin e veprimeve dhe përfundimin e procedurës, me arsyetimin se duke u bazuar në dispozitën e nenit 43 paragrafi 4 të Ligjit për procedurën përmbareimore përcaktohet se “ *Përmbareuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbareueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbareueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareueshmërisë së nxjerrë nga përmbareuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbareimit rishikon nëse janë*

plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”. Ndërsa me nenin 73 paragrafi 4 të Ligjit (Nr. 05/L-118) Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se “ Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala debitorë ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështrojnë sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka ndaluar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.78/2022 të dt. 21.02.2022.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.533/24 dt. 02.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi